

Data __. __. 2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: : Mbikëqyrje punimesh për procedurën me objekt “Ndërtimi i dhomës frigoriferike kufomambjatëse”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mbikëqyrja e punës së ndërtimit 71247000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit në total është 1,209,139 lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Instituti i Mjekësisë Ligjore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c)shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm:** i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e ta ardhurave nga veprimtaria ekonomike; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet të qëndrueshëm ekonomik gjatë dy viteve të fundit. Për të verifikuar përmbushjen e kësaj kërkesë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, kopje të vërtetuara të balanceve, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) të viteve 2021 dhe 2022.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit i **kontratës objekt prokurimi**. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori Ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas adresave të regjistruara sipas QKB-së. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruara sipas QKB-së. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, i ndryshuar”.

2.3 Aftësitë teknike:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me **vlerë jo më të vogël** se 20 % e vlerës së përlogaritur të objektit që prokurohet, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimit për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes dhe/ose faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen data, shumat si dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

Shënim: Formulari i vlerësimit në rastin e punës së ngjashme kryer nga BOE duhet të tregojë saktësisht % e ndarjes së punës midis OE. Paraqitja e një formulari të mbushur jo sipas formatit zyrtar, do të konsiderohet kusht për mos njohjen e punës respektive.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e mbikqyrjes, formularin e vlerësimi/vërtetim për realizimin e shërbimit të mbikqyrjes, ku të shënohet vlera, afati i kontratës dhe objekti i mbikqyrjes së realizuar.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë kontrata shërbimi të ngjashme në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë për një vlerë sa jo më të vogël se 20 % e të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është në kufirin e ulët monetar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për mbikëqyrje të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në VKM-në Nr.759, datë 12.11.2014 “Për licensimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr.43, datë 28.12.2026”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

N.P-1 Punime gërmimi në tokë

N.P-3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industrial, veshje fasada

- N.P-7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
N.P-11 Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve, linjë e re TN e të mesme dhe shpërndarje e energjisë

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S-1 Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre
N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashënsorë, shkallë lëvizëse, transportues)
N.S-4 Punime rifiniture të maturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
N.S-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
N.S-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
N.S-18 Punime topogjeodezike
N.S-19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë
N.S-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, panvarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 7 dhe 7/1 përcakton "Në rastet kur autoritetet publike investojnë dhe realizojnë një zhvillim në një zonë të caktuar, mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve përzgjidhet nga autoriteti publik në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **drejtues teknikë në licencën e shoqërisë ofertuese**, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1(një)
- Inxhinier Hidroteknik 1(një)
- Inxhinier Elektrik 1(një)
- Inxhinier Mekanik 1(një)
- Inxhinier Topograf 1(një)
- Inxhinier Gjeolog 1(një)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

-Kontratat e punës individuale, të vlefshme

- Diplomën përkatëse

-CV

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë inxhinierët e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikimeve teknike. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për mbikëqyrjen e këtyre punimeve të ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhembikëqyrjen e zbatimin e punimeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se ka zëra pune ku del e qartë domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e inxhinierëve të kërkuar.

Inxhinieret e kërkuar janë në përputhje me licencat e kerkuara.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf të specializuar për kryerjen e shërbimeve të mbikqyrjes objekt kontrate, si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatën “Koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 , datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëntesin në punë”, VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010 “Për sigurinë në kantier”, VKM-së nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara , që meren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Dilpomë/certifikatë, Libreze pune si dhe të figurojnë në listëpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit e dokumentacionit shoqërues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, dhe

Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, të nevojshme për mbikëqyrjen e ekzekutimit të objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo më pak se 7 (shtatë) punonjësish, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimum 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:*

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore për periudhën 3(tre) muajt e fundit të deklaruar.
- Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) mujt e fundit të deklaruar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit e dokumentacionit lartpërmendur.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar tek kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje, (3 muaj), tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në

tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Analizat teknike janë bazuar në VKM-në nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). (Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore. Ky kriter është gjithashtu i bazuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

Vendosja e kërkesave të mësipërme është bërë për të vërtetuar kapacitetin teknik të OE, i cili duhet të disponojë një staf të mjaftueshëm jo më pak se 7 punonjës, për të përmbushur me sukses dhe në kohë kontratën. OE duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Pajisje GPS 1 (një) copë
- Pajisje total Station 1 (një) copë
- Automjet 1(një) copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të nakimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi për pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion si, fatura tatimore shitblerje ose kontratë qiraje.
- Për mjetet me pronësi që shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë rregjistrimin e mjetit si: Leje qarkullimi, siguracionin e mjetit dhe certifikatën e kontrollit Teknik të vlefshme.
- Për mjetet e marra me qera dokumentave të mësipërm ti bashkëlidhen kontrata përkatëse e qerasë / leasing / huapërdorjes, në emër të objektit, dhe afati i të cilave të përfshijë periudhën e ndërtimit të objektit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë pajisjet dhe mjetet e mësipërme, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili është publikuar së bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.7 Operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- a) Certifikatë ISO 9001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- b) Certifikatë ISO 14001-2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- c) Certifikatë ISO 45001-2018 mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikata emësipërme, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcak tuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi. Në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara ne nenin 76 te LPP-së dhe ato të përcaktuara

në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Për sa më lart, gjykohet se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zërat elektrik të Preventivit. AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve në lidhje me përcaktimin: Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” , të ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi për ndërtimet, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të objektit dhe projekteve përkatëse të zbatimit (projektin e punimeve ndërtimore, projektin e punimeve elektrike dhe projektin e punimeve hidro-sanitare) me qëllim përshkrimin e cilësisë të të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesave të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

Fondi limit për këtë procedurë është përllogaritur në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 354 datë 11.05.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori , Projektim, Mbikëqyrje, dhe Kolaudim”.

Komisioni i hartimit të dokumentave standarte